

Nr. 1000/17.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

6764
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 14.10.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.88

Data: 11.10.2022

“Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare për znj. Shpresa Xhediku.”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Handwritten signature



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

4764/1910/22

Nr.1008/1 prot.

Peshkopi, më 18.10.2022

Lënda: Për vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË

DIBËR

Në mbështetje të nenit 16-të të ligjit nr.107 datë 27.10.2016, "Për Prefektin e Qarkut", pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin nr.88 (tetëdhjetetë) datë 11.10.2022, të Këshillit të Bashkisë Dibër, "Për akordim fondi në mbulimin e dëmit financiar nga emergjencat civile, për dëmtim prone nga faktorët natyror apo njerëzor", **vendosa:**

Miratimin në parim të kësaj vendimmarrje në kushtet e respektimit të legjislacionit aktual në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e së drejtës.

Duke ju falenderuar për mirkuptimin.

P R E F E K T I I
Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 88 Datë 11/10 /2022

“ Për miratim fondi për ndihmë shtetërore financiare”

Në mbështetje të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr.107 datë 22.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr.45 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”, VKM nr.329 datë 16.05.202012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” Kreu III,pika 1, gërma ë, dhe kreu III, pika 3, gërma ç, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **11.10.2022** me 21 vota pro, 0 kundër dhe 0 apsteminim:

VENDOSI:

1. Të miratohet dokumentacionin tekniko-ligjor.
2. Të njohë vlerën totale të dëmit për objektin **shtëpi banimi 2 kat** në pronësi të znj.**Shpresa Xhediku**, Njësia Administrative Kastriot (fshati Sohodoll), në shumën totale **661344** lekë sipas dokumentacionit të paraqitur nga ana e komisionit për këtë qëllim. Nga kjo vlera e dëmit ndërtimor **406344** lekë dhe vlera e dëmit orendiak **255000** lekë.
3. Nga fondi i emergjencave civile të Bashkisë Dibër të trajtohet i dëmtuari në shumën prej **330672** lekë (50% të vlerës totale të dëmit) për ti përdorur për riparimin e dëmit të shkaktuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli

Sokol Sava

